REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 1364/20
Nr. i fq. / Br. st -68-
Data: / Datum 31.12.2020
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

K r y e t a r i

PLANI I PUNËS
I KRYETARIT TË KOMUNËS – QEVERISË KOMUNALE PËR VITIN 2021

Dhjetor, 2020

Plani i punës i Kryetarit të komunës përkatësisht qeverisë komunale për vitin 2020 paraqet prioritetet, objektivat, aktivitetet e planifikuara, si dhe realizimin e tyre. Po ashtu, përcakton edhe treguesit, si dhe afatet kohore për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara. Ky plan natyrisht që gjatë vitit 2021 do të mund të plotësohet varësisht prej nevojave dhe mundësive buxhetore.

Përmes këtij plani ne do të mund të kanalizojmë nismat për planifikim të objektivave, përkatësisht prioriteteve, të cilat do të mund të realizohen bazuar në planifikimin buxhetor të vitit 2021 për realizim të projekteve kapitale të cilat i kemi planifikuar në këtë vit për t'i realizuar në vitin që po hyjmë 2021. për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët tanë. Gjatë përmbushjes së këtyre objektivave sigurishtt që ka sfida sikur që kemi pasë këtë vit për shkak të pandemisë COVID-19, por me një angazhim të përbashkët të Qeverisë komunale dhe të kuvendit mund të arrihen rezultate të dëshirueshme. Duam të besojmë se këto probleme dhe vështirësi që i kemi pasë këtë vit nuk dot na përsëriten edhe në vitin 2021, me shpresën se kjo pandemi do të kaloj me kalimin e sezonit të këtij dimri.

Prioritetet kryesore të cilat janë të përfshira në këtë plan gjatë vitit 2021:

- Rimëkëmbja ekonomike nga pandemia COVID-19
- Kyçjet në rrjetin e ujësjellësit i të gjitha familjeve në të gjitha vendbanimet atu ku është shtrirë rrjetit primar dhe do të vazhdohet me ndërtim të rrjetit sekondar;
- Mbështetja në fillimin e funksionalizimit të Ndërmarrjes Publike Komunale "Përparimi" tani më të themeluar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Funksionalizimi i Parkut Industrial në fsh.Lumadh;
- Sigurimi i lokacionit për ndërtimin e Stacionin e Autobusve;
- Ghjetjae mundshme e donatorëve për ndërtim të Tregut për prodhues vendor;
- Menaxhimi efektiv dhe transparent i buxhetit të komunës;
- Transparencë dhe llogaridhënie për qytetarët e administratës komunale;
- Raportimi i rregullt në kuvendin e komunes (çdo 3 muaj) për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore e sipas nevojes edhe sipas kërkesës së kuvendit;
- Implementimi sipas planifikimit dhe me kohë i projekteve kapitale si dhe angazhimi per shpenzim 100 % të mjeteve financiare të investimeve kapitale sidomos mjeteve të grantit qeveritar;
- Angazhimet per realimin e të hyrave të planifikuara buxhetore;
- Do të vazhdojmë me përmirësimin e infrastrukturës së terreneve sportive;
- Qendra Inovative e Vushtrrisë
- Ndërtimi i Qendrës për qëndrim ditor për të moshuarit
- Funksionalizimi i Muzeut të Qytetit
- Ndërtimi i parqeve në hapësira publike
- Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik

- Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica në pjesën e qytetit;
- Vazhdimi i punimeve në rregullimin e shtratit të lumit "Podrança"
- Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëseaty ku do tëjetëe nevojshme,
- Zgjerimi i rrjeteve te vendosjes së kamerave në qytet dhe shkolla
- Ndërtimi i çerdhes
- Ngritja e bashkepunimit me organet e nivelit qendror në implementimin e projekteve të cilat financohen nga buxheti i Republikës së Kosoves;
- Shfrytëzimi sa më racional i pronave (tokave dhe objekteve) në pronësi të komunës përmes dhënies në shfrytëzim
- Ndërmarja e masave per lirimin e pronave komunale te uzurpuara; publikimi i të gjithë uzurpuesve të pronës komunale;
- Angazhimet për gjetjen e donatorëve per investime të reja;
- Rritja e prodhimtarisë bujqësore përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve;
- Organizimi i trajnimeve dhe këshillimeve profesionale
- Subvencionimet e bujqëve,
- Mbrojtja e pyejeve nga prerësit ilegal;
- Do të vazhdohet me ndërtimin e rrjetit te kanalizimmeve në zonat rurale;
- Kujdesi për ambient të pastërt,
- Menaxhimi më i mirë i mbeturinave duke marrë për bazë planin për menaxhimin e mbeturinave;
- Gjithperfshirja në arsim dhe ngritja e cilësisë së punës në institucionet e arsimit;
- Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore,
- Promovimi perkatesisht avancimi i aktiviteteve kulturore, të rinisë dhe në lëmin e sportit,
- Përmes fondit të subvencioneve, ofrimi i mbeshtetjes se klubeve sportive, organizatave të dalura nga lufta e UCK-së, organizatave rinore, OJQ –ve tjera të komunës, si dhe kategorive tjera ne veqanti familjeve skamnore.
- Bashkepunimi me organet e nivelit qendror veqanerisht me Qeverine dhe ministrite e linjes në aspektin e zbatimit të ligjshmerise me rastin e marrjes së vendimeve me rendesi dhe interes për komunen dhe qytetaret,
- Bashkepunimi me organizatat vendore e nderkometare,
- Angazhime tjera për çështje me rëndësi dhe interes përqytetarët përmirëqenje dhe jetë më të mirë të tyre.

Planifikimet sipas drejtorive

Buxheti dhe Financat

Nr.	Drejtoria	Objektivat	Aktivitetet	Afati	Pjesëmarrësit tjerë	Ndërlidhja me
1	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1.Përgatitjet fillestare për fillimin e sistemit të pagesave (Free Balanc) për vitin fiskal 2021.	1.Kompletimi i dokumentacionit për të gjitha programet buxhetore dhe monitorimi i tyre	Janar/2021	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
2		2.Rregullimin e dokumentacionit për personat me autorizimet e veçanta : nëpunësi administrativ i pagesave, personi autorizues, personi aprovues, personi zotues dhe certifikuesi për periudhën 2021.	2.Plotsimi i kërkesës për qasje të përdoruesve në SIMFK.	Janar/2021		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
3		3.Pasqyrat financiare për buxhetit për vitin 2020	3.Plotsimi më efikas dhe dorëzimi i PVF	Janar/2021		
4		4.Përgatitje e raportit vjetor për të hyrat dhe shpenzimet për vitin 2020	4.Prezentimi në Kuvendun Komunal	Janar /2021		
5		5.Përgatitja e rrjedhës së parasë për të gjitha programet për vitin 2021	5.Plotësimi i formularëve të rrjedhës së paras në bazë të planifikimit të buxhetit në MEF.	Janar/2021		
6		6.Bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2020	6.Implementimi i të hyrave të bartura në vitin 2021	Shkurt-Mars/2021		

7		7.Përgatitja për inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe taksa në firmë.	7.Evidentimi i të gjitha pronave dhe bizneseve që ushtrojnë veprimtarin e tyre lidhur me të hyrat e pa arkëtuara nga T.P dhe T.F	Janar/dhjetor2021		
8		8.Përgatitjet e duhura për realizimin e projekteve dhe pagesave tjera të pa kryera nga viti 2020 .	8.Kompletimi i dokumentacionit për zotimin e mjeteve	Janar/Shkurt-/2021		
9		9.Barazimi mujor i shpenzimeve në sistemin FB	9.Përmbajtja e afatit kohor në bazë të Udhëzimit administrativ 02/2010	Çdo muaj/2021		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
10		10.Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave vetanake për çdo tre muaj	10.Përgaditja e raportit lidhur me realizimin e buxhetit dhe inkasimin e të hyrave për të gjitha programet buxhetor dhe prezentimi në K.K	Çdo tre muaj/2021		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
11		11.Prezantimi i Qarkores 01/2022 i kufijve të parë buxhetor dhe përpunimi i buxhetit për vitin 2022 konform qarkoreve të marrura nga MEF-i	11.Harmonizimi i kërkesave të drejtorive për buxhetin e vitit 2022.	Maj-Qershor/2021		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
12		12.Përgatitjet për rishikimin buxhetor (varësisht nga kërkesat e MEF-it)	12.Përgaditja e formularëve lidhur ndryshimet buxhetore	Qershor-Korrik/2021		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

13	_	13.Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore të mjeteve sipas dinamikës së paraparë për gjashtëmujorin e parë për vitin fiskal 2021	13.Raportimi informatës lidhur me projektet e realizuara në bazë të planifikimit të buxhetit	Korrik/2021		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
14		14.Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronë.për vitin 2022	14.Dorzimi në MEF,DPT	Korrik/2021		
15	_	15.Përgatitja e tregueseve final buxhetor për vitin 2022 konform qarkoreve nga MEF-i	15.Finalizimi i buxhetit sipas kërkesave te drejtorive për vitin fiskal 2022, dhe aprovimi nëK.K	Shtator/2021		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
16	_	16.Përgatitjet për përmbylljen e vitit fiskal buxhetor 2021		Dhjetor/2021		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Participojnë							
Nr.	**Emri i projektit**	**Shuma-€**	**Komuna**	**Donatorët**	**Përfituesi**	**Periudha kohore**	**Zhvillimet**
1.	Projektet e planifikuara për zhvillimin e aktiviteteve dhe krijimin e kushteve më të mira në QKB		Vushtrri 21	Grande 10		Janar-Dhjetor 2021	Qendra Komunale e Biznesit tani është në funksionim të plotë dhe si e tillë është në kursim të mjeteve financiare dhe të kohës për të gjithë të interesuarit për të zhvilluar biznes ; Përpjekjet tona do të jenë për zvoglimin dhe eliminimin e të gjitha barrierave për të bërë biznes,në shkurtim të kohës për regjistrim të biznesit,dhe në përpjekje me rekomandime profesionale në përmirësim të ngarkesave

							komunale në raport me bizneset.
2.	Makina kositje për traktor	20,000				Shkurt-Mars 2021	Me këtë projekt kemi synimin e përkrahjes së familjarëve dhe fermerëve me qellim të rritjes së vendeve të reja të punës. Këto vende pune do të krijohen në formën e vetëpunësimit.
3.	Makina për mbiellje të misrit	30,000				Shkurt-Mars 2021	Me këtë projekt synohet përkrahja e Fermerëve dhe Ekonomive familjare.
4.	Makina për lëvrim (Freza Traktori)	50,000				Prill-Maj 2021	Me këtë projekt ne synojmë zhvillimin e sektorit të Bujqësisë dhe lehtësimin e punës së Fermerve.
5.	Rregullimi i kanaleve kulluese	51,000				Qershor-Korrik 2021	Rritja dhe forcimi i Ekonomive Familjare në Sektorin e Bujqësisë
6.	Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave	60,000				Prill-Qershor 2021	Ky projekt mundëson ruajtjen dhe mbrojtjen e tokave bujqësore nga vërshimet eventuale ,pra është preventivë.
7.	Pastrimi i lumenjve	83,000				Prill-Korrik 2021	Me këtë projekt kemi synimin e përkrahjes së fermerëve me qellim të mos dëmtimit të kulturave bujqësore nga vërshimet nëpër toka të punuara.
8.	Fondi për bashkëfinancim	85,000				Shkurt-Nëntor	Rritja dhe forcimi i ekonomive familjare në sektor të bujqësisë.
9.	Ngritja e serave	20,000				Marsl-Maj 2021	Më këtë projekt synojmë të realizojmë me bashkëfinancim me fermerët zgjerimin e sipërfaqeve me sera për kultivimin e perimeve për nevoja familjare dhe të tregut.
10	Ngritja e pemishteve me arra dhe lajthi	20,000				Mars-Maj 2021	Ky projekt ka për qëllim ngritjen e plantacioneve me pemë dhe krijimin e kushteve më të mira për prodhuesit vendor që të kenë mundësi për zhvillim të veprimtarisë. Krijimi i vendeve të punës si të vetëpunësuar.
11	Paisje për	40,000				Maj –Qershor	Furnizimi me paisje për Bletari mundëson zhvillimin e

	Bletari						kësaj dege dhe krijon vet punësime. Konsumatori siguron ushqime më të shëndetshme.
12	Dita e patates	5,000	DEBPZHR			1-10 Tetor 2021	Organizimi"Dita e patates" është organizim komunal dhe ka për qëllim promovimin e kësaj kulture.
13	Mbjelljet pranverë-vjeshtë					Shkurt-prill Nëntor	DEBPZHR ka për obligim që të përcjell mbjelljet,mbaj statistikat të llojeve dhe te jetë në dijeni për kahet e zhvillimit të Bujqësisë në Komunë.
14	Korrje-shirjet					Korrik-Gusht 2021	Organet Komunale përcjellin procesin e korrje-shirjeve, ndajnë territorin e autokombajnave. Kryetari i Komunës emëron komisionin për mbikëqyrje,mblesin statistika për numrin e kombajnave ,sipërfaqen e nevojshme për korrje –shirje dhe raportojnë për ecurinë e procesit dhe raportojnë për rendimentet e prodhimit. Të gjitha këto të dhëna dorëzohen në DEBPZHR dhe dërgohen në MBPZHR .
15	Grandet në bujqësi			MBPZHR		Pranverë-Verë 2021	Thirrje për aplikim në grande për degët e bujqësisë,këshilla profesionale dhe ndihma në plotësimin e aplikacioneve.
16	Pastrimi dhe pyllëzimi			Agjencioni i Pylltarisë(AP		Pranverë – Vjeshtë	Pastrimi i pyjeve në Qyqavicë është projekt i Agjencionit të pyjeve. Pyllëzim nuk kemi të planifikuar
17	Subvencionimi i kulturave lavërtare			-MBPZHR		Pranverë-Vjeshtë	Subvencionimi i kulturave grurë, misër, sojë, luledielli, patate, kunguj, gjedhe, dele, dhi, bletë etj.
	GJITHSEJ	464.000					

Aktivitetet në Drejtorin për Ekonomi, Bujqësi,Pylltaridhe Zhvillim Rural janë të planifikuara që të organizojnë mirëfilltë punën në kuadër të kompetencave që kemi, njëkohësisht duke krijuar mundësi dhe qasje të barabartë për të gjithë.
Përpjekje tona në vazhdimësi janë riorganizimi dhe ngritja e kapacitete të brendshme me qëllim ofrimin sa më të mirë të shërbimeve për qytetarët e Komunës.
Prioritet mbetet ngritja graduale e buxhetit (në proporcion me resurset menaxhuese) dhe me nevojat/kërkesat që kemi si dhe ndërtimi i fuqishëm i raporteve me donatorët dhe OJQ-të e ndryshme.
Në detajet buxhetore , prioritet janë të orientuara në :

1- Në komunën e Vushtrrisë në çdo vit vërehet dukshëm një orientim i madh i fermerëve në ndërtim të serrave me qëllim të kultivimit të perim-kulturave. Veçmas dallohet kultivimi i specave,domates dhe kornishonit (trangujve të vegjël) dhe BAM . Ky investim në serra për fermerët tonë është një burim i mirë për një mirëqenie më të mirë familjare duke gjeneruar të hyra. Vlerësohet që investimet në projekte të tilla zbusin papunësinë, krijojnë të hyra për fermerët tonë dhe të gjithë qytetarët kanë mundësi të shërbehen me produkte kualitative, më të freskëta por edhe me çmime më të lira për faktin se nuk i nënshtrohen importit.
2- Realizimi i projektit për rregullim të bademeve (bankinës) është projekt shumë kapital dhe afatgjatë. Investimet në këtë projekt kursejnë qindra-mijëra euro nga xhepat e fermerëve. Është projekt me kosto të lartë financiare por mendohet që gradualisht në çdo vit të kemi mjete buxhetore të planifikuara për këtë projekt dhe të rregullohen të gjithë bedenat, me prioritet pikat më emergjente;
-3-Pyjet në komunën tonë, ashtu si në gjithë territorin e Kosovës nuk janë në gjendje të mirë. Si rezultat i pranimit të kompetencave nga MBPZHR dhe me qëllim mbrojtjen dhe kujdesin ndaj pyjeve llogarisim se na duhet të ndërmarrim hapa konkret në këtë drejtim se bashku me Axhencionin e Pyjeve të Kosovës për ripyllëzime.;

Administratë

Aktivitetet	Afati i zbatimit	Përgjegjës	Mbështetës	Produkti
1. Azhurimi i informacioneve lidhur me shërbimet administrative që ofrohen nga Komuna.	Mars 2021	Drejtoritë/Zyrat Q.SH.Q.K	Kryetari i komunës	Shërbimi i azhuruar me kërkesat dhe nevojat aktuale.
2. Funksionalizimi i arkivit të administratës së Komunës	Qershor 2021	Drejtoritë	Kryetari i komunës	Arkivi funksional dhe profesional
3. Implementimi i koncept dokumentit për ofrimin e shërbimeve më të mirë dhe sa më pranë qytetarëve dhe bizneseve.	Korrik 2021	Q.SH.Q.K dhe drejtoritë komunale	Zyra e kryetarit Drejtoritë	Funksionimi në bazë të koncept-dokumentit
4. Hartimi i fletushkave, informacioneve dhe broshurave lidhur me shërbimet e Komunës.	Mars 2021	Q.SH.Q.K	Kryetari i komunës	Informim i shpejt dhe i sakt, transparencë më e lartë.
Furnizim me TI	Prill 2021	Drejtori i drejtorisë		Pajisje të TI
Trajnimi i Nëpunësve Civil.	prill 2021	Zyra e personelit në bashkëpunim me IKAP dhe Drejtoritë		150 punonjës civil te trajnuar
Informimi dhe vetëdijesimi i qytetarëve në vazhdimësi lidhur me aktivitetet e Komunës.	Gusht dhe në vazhdimësi 2019	Zyra për komunikim me publikun	Drejtoritë	Fushatë informuese Reklama fletushka informuese

Zyra e gjendjes civile

Qëllimi kryesor(Objektivat)	Aktiviteti(Detyrat)	Afatet	Bartësit
1. Përditësimi i shënimeve dhe të dhënave personale të qytetarëve në Regjistrin qendror elektronik të gjendjes civile dhe administrimi i regjistrave themeltar fizik. 60.000/2%-(Toleranca e gabimeve).	1.1.Verifikimi i qytetareve në regjistrin themeltarë elektronik dhe unifikimi i të dhënave dhe shënimeve me regjistrit themeltar fizik dhe elektronik. 1.2. Mirëmbajtja dhe kujdesi i regjistrave themeltar fizik dhe elektronik dhe të dokumenteve të arkivuara. 1.3. Përditësimi i shënimeve dhe regjistrimi i shtetasve në regjistrin themeltar dhe regjistrin qendror elektronik. 1.4. Regjistrimi i shtetasve sipas nenit 31 dhe 32 të ligjit për gjendjen civile. 1.5. Përditësimi dhe regjistrimi në regjistrin themeltar dhe qendror të vendbanimit dhe vendqëndrimit, 1.6.Riregjistrimi(Rikonstruksioni) i personave që dëshmojnë që kanë qenë të regjistruar më parë në regjistrin themeltarë. 1.7. Regjistrimi i shtetasve të huaj në regjistrin qendror, 1.8. Regjistrimi i personave të natyralizuar sipas vendimit të MPB-së, 6.6. Përdorimi dhe shfrytëzimi i aplikacionit të GJC sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë,	Sipas afateve ligjore.	Zyrtarët e Gjendjes civile
2. Shqyrtimi i kërkesave dhe nxjerrja e vendimeve për korrigjimin, ndërrimin dhe regjistrimin me vonesë të fakteve të lindjes dhe fakteve të vdekjes. 450/2%-(Toleranca e gabimeve).	2.1. Nxjerrja e vendimeve për korrigjime të të dhënave personale, 2.2. Nxjerrja e vendimeve për ndërrim të emrit personal, 2.3. Nxjerrja e vendimeve për regjistrim me vonesë të faktit të lindjes dhe vdekjes, 2.4. Nxjerrja e vendimeve për anulimin e regjistrimeve të faktit të lindjes, 2.5. Nxjerrja e vendimeve për korrigjimin e akteve të lindjes, martesës dhe vdekjes, 2.6. Nxjerrja e vendimeve për korrigjimin e librit fizik të lindjes, martesës dhe vdekjes,	Sipas afateve ligjore.	Zyrtarët e Gjendjes civile

3.Regjistrimi i fakteve të lindurve dhe të të vdekurve në regjistrat themeltar, shtypja dhe mbajtja e akteve në mënyrë korrekte dhe cilësore duke krijuar dosje për së cilën rast dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve. 1500/1%-(Toleranca e gabimeve).	3.1. Pala duhet të informohet shpejtë, saktë, me shkrim dhe me gojë, 3.2. Regjistrimi i fakteve të lindjeve, martesave dhe vdekjeve në regjistrin themeltar dhe në regjistrin Qendror elektronik të gjendjes civile, 3.3. Të gjitha aktet duhet të shtypen dhe të pasqyrojnë shënimet e sakta, të nënshkruhen nga zyrtari, pala dhe të vulosen, 3.4. Regjistrimet e mëvonshme në bazë të vendimeve, 3.5. Regjistrimet e veçanta(speciale),faktet që ndodhin jashtë vendi, 3.6. Regjistrimi i fëmijëve të adoptuar në bazë të vendimit të gjykatës, 3.7. Të regjistrohen të gjithë personat e natyralizuar sipas vendimit të DSHAM-së, 3.8. Të krijohen aktet dhe të arkivohen dhe në fund të vitit të lidhen libër, 3.9. Gjenerimi dhe lëshimi i numrin personal,	Sipas afateve ligjore.	Zyrtarët e Gjendjes civile
4. Regjistrimi i martesave brenda orarit të punës dhe regjistrimi i martesave jashtë selisë së komunës dhe jashtë orarit të punës, duke i shtypur dhe mbajtur aktet në mënyrë korrekte, cilësore dhe duke krijuar dosje për së cilën rast dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve te martesave. 900/1%-(Toleranca e gabimeve). 100/1%-(Toleranca e gabimeve).	4.1. Identifikimi i palës përmes një dokumenti të identifikimit, 4.2.Informimi i palëve për kushtet dhe procedurat e kurorëzimit, 4.3. Caktomi i terminëve për lidhjen e martesës, 4.4. Shpallje e martesave, 4.5. Sigurimi i ambient solemn dhe komod për çiftet me rastin e martesës, 4.6. Regjistrimi i shtetaseve të huaj në regjistrin qendror me rastin e paraqitjes së kërkesës për kurorëzim, 4.7. Të gjitha aktet shtypen dhe pasqyrojnë shënimet e sakta, pastaj nënshkruhen nga zyrtari dhe çifti dhe vulosen, 4.8.Aktet arkivohen në dosje sipas lëndës dhe digjitalizohen, 4.7. Lidhja e martesave jashtë selisë së komunës, 4.9. Lidhja e martesave jashtë orarit të punës në selinë e komunës,	Sipas afateve ligjore.	Zyrtarët e Gjendjes civile
5. Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të tjera të Gjendjes Civile, si dhe dhënia e shërbimeve të tjera në mënyrë efektive dhe pa gabime. 70000/2%-(Toleranca e gabimeve) 10000/1%-(Toleranca e gabimeve)	5.1. Identifikimi i palës përmes një dokumenti të identifikimit, 5.2. Informimi i shpejtë dhe i saktë, me shkrim dhe verbal, 5.3. Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve në mënyrë efektive, 5.4. Komunikimi korrekt i zyrtarit me palë duke respektuar kodin e etikës, 5.5. Inkasimi i drejtë i pagesave për shërbimin e dhënë, printimi dhe nënshkrimi i fletëpagesës nga pala dhe zyrtari,	Sipas afateve ligjore.	Zyrtarët e Gjendjes civile

	5.6. Certifikatat dhe dokumentet i jepen vetëm personit që i përkasin, përveç rasteve me prokurë, 5.7. Respektimi i orarit të punës, 5.8.Zbatimi i vendimeve për ndryshimin dhe korrigjimin e të dhënave personale në regjistrin qendror elektronik, 5.9. Përcjellja e vendimeve për ndryshime dhe korrigjime të të dhënave personale në regjistrin themeltar fizik, 5.10..Zbatimi i Aktgjykimeve të gjykatës për shkurorëzim, 5.11..Zbatimi i vendimeve për regjistrimin e mëvonshëm të fakteve të lindjes dhe vdekjes, 5.12..Zbatimi i raportit policor për dokumentet e humbura, 5.13...Zbatimi i deklaratës për kthimin e mbiemrit të lindjes pas shkurorëzimit, 5.14..Zbatimi i deklaratës së Atësisë-Amësisë 5.15. Zbatimi i vendimit të gjykatës mbi themelimin e adoptimit 5.16. Kompletimi i dosjes për fitim dhe humbje të shtetësisë, 5.17. Kërkesa për natyralizim(fitim) parashtrohet personalisht, 5.18. Kërkesa për humbje me lirim të shtetësisë bëhet personalisht, 5.19. Pala duhet të trajtohet nga zyrtari deri në fund duke qenë i kujdesshëm, 5.20..çdo certifikatë e dëmtuar duhet të raportohet dhe të anulohet në sistem 5.21.. Ruajtja e regjistrave dhe dosjeve me të DHP në orman metalik ku siguria e tyre është e garantuar,		
6. Azhurnimi i 80000 kërkesave në intranet duke ju dhënë përgjigje dhe zgjidhje në mënyrë efektive dhe pa gabime. 80000/1%-(Toleranca e gabimeve)	6.3. Komunikimi dhe sqarimi i palës në lidhje me procedurat duhet të jetë prioritet i zyrtarit, 6.4. Ofrimi i shërbimeve duhet të jetë i shpejtë dhe sa më efikas 6.5. Aftësimi dhe njohja sa më e mirë e kompjuterit dhe aplikacionit të gjendjes civile dhe intranetit, 6.7. Informimi dhe përgjigje në kërkesat e palëve përmes internetit, 6.8. Komunikimi përdorimi i email-it zyrtar, 6.9. Krijimi i dosjes për çdo kërkesë (kërkesa, fletëpagesa dhe ID) 3.3. çdo kërkesë duhet të marr përgjigje brenda ditës në Intranet, 3.4. Raportimi, ditor, javor dhe mujor,	Sipas afateve ligjore.	Zyrtarët e Gjendjes civile

7. Ruajtja e fshehtësisë së të dhënave personale dhe komunikimi i tyre vetëm personave që i parasheh ligji.	7.1. Të dhënat personale i komunikohen vetëm personit për të cilën mbahen shënimet. 7.2. Certifikatat dhe dokumentet i jepen vetëm personit që i përkasin, 7.3. Ruajtja e regjistrave dhe dosjeve me të DHP në orman metalik ku siguria e tyre është e garantuar.		Zyrtarët e Gjendjes civile

Sektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative

Objektivat	**Aktiviteti(Detyrat)**	Afatet	Bartësit	Vërejtje
1. Funksionaliteti i tërë sistemit të teknologjisë informative të administratës së komunës	1.1 Implementimi i të gjitha politikave dhe procedurave të TI; 1.2 Kujdesi për zbatimin e politikës së sigurisë së rrjetit, shfrytëzimit të resurseve të TI; 1.3 Jap propozime lidhur me buxhetin vjetor lidhur me investimet dhe mirëmbajtjen e TI;	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i sektorit	
2. Administrimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë për të siguruar qasje maksimale	2.1 Administrimi i serverëve dhe pajisjeve tjera qendrore të sistemit të TI në Komunë; 2.2. Mirëmbajtja, instalimi, konfigurimi, testimi dhe zgjerimi i rrjetit; 2.3 Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshme si dhe zgjidhja e probleme të ndryshme sofuerike; 2.4 Administrimi dhe mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare, aplikacioneve dhe bazave të të dhënave të komunës; 2.5 Evitimi i defekteve dhe rekomandimi për servisim të pajisjeve të TI;	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i sektorit; Zyrtari i TI	
3. Mbështetje lidhur me përdorim dhe shfrytëzim të resurseve të TI	3.1 Trajnon dhe aftëson stafin për përdorim të teknologjisë ekzistuese dhe teknologjive të reja; 3.2 Ofrimi i qasjes për gjithë personalin në sistemin e TI dhe resurset e saja;	Gjatë tërë vitit		

4.Menaxhimi dhe administrimi i punëve të përbashkëta	4.1 Identifikimi i nevojave për drejtorinë për furnizim me pajisje, inventar dhe mirëmbajtjen e tyre; 4.2 Mbikëqyrja e punës lidhur me lekturim dhe përkthim; 4.3 Mbikëqyrja e mirëmbajtjes së objektit të komunës	Gjatë tërë vitit	Udhëheqë si Sektorit	
5. Ofrimi i shërbimeve të përkthimit	5.1 Përkthim në mbledhjet e organizuara nga kryetari, Kuvendi i komunës si dhe mbledhje, takime, etj 5.2 Përkthimi i të gjitha dokumenteve sipas kërkesave të zyrtarëve të administratës komunale.	Gjatë tërë vitit	Përkthyesi	
7. Ofrimi i shërbimeve të lekturës	7.1 Lekturimi i dokumenteve të kuvendit, kryetarit dhe dokumenteve të shërbimeve tjera sipas kërkesave të zyrtarëve të administratës komunale; 7.2 Asistim në përpilimin e terminologjisë së unifikuar ligjore dhe arsimore 7.3 Mbështetje stafit lidhur me shkresat në përmbajtjen e tyre në aspektin e strukturës sintaksore (gjuhësore)	Gjatë tërë vitit	Lektori	
8. Pranimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve	8.1 Inspektimi, testimi dhe nënshkrimi i pranimit të materialeve, punëve dhe shërbimeve; 8.2 Parashtron kërkesë te Drejtori i drejtorisë ose Menaxheri i Prokurimit në rast nevoje për formimin e komisioneve për pranim; 8.3 Mban evidence për pranimin e mallit dhe i proceson të dhënat në sistem; 8.4 Mban shënime mbi dërgesat e mallit si dhe shpërndarjen e tij 8.5 Bënë dorëzimin e dokumentacionit me protokoll në drejtim të zyrtarit të pasurisë me qëllim të regjistrimit të pasurisë	Gjatë tërë vitit	Zyrtari i pranimit	

9. Mirëmbajtja e të gjitha stabilimenteve elektrike dhe teknike në lokalet e ndërtesës së komunës si dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit në objektin e komunës, pastërtisë dhe nyjave sanitare.	9.1 Ndërrimi dhe riparimi i stabilimenteve, montimin e pjesëve të reja sipas nevojës së parashtruar; 9.2 Kujdesi per funskionalitetit e sistemit te ngrohjes/ftohjes 9.3 Mirëmbajtja e inventarit nëpër zyra; 9.4 Kujdesi për funksionalitetin e gjeneratorit dhe ashensorit 9.5 Kujdesi për furnizimin me mjete higjienike për nevoja të objektit të komunës	Gjatë tërë vitit	Operatori teknik-Mirëmbajtësi	

Qendra për Shërbim për Qytetar

Qëllimi kryesor(Objektivat)	**Aktiviteti(Detyrat)**	Afatet	Bartesit	Verejtje
Pranimi i te gjitha kërkesave/ankesave te parashtruara nga qytetaret/bizneset dhe grupet e interesit.	1-1 .Pranimi dhe regjistrimi i lendeve ne sistem 1.2 Pranimi dhe skanimi i te gjitha lendeve te parashtruara nga palët drejtuar institucionit te Komunës 1.3. Informimi i duhur mbi procedurat qe duhet te ndjekin palët me rastin e paraqitjes se kërkesës 1.4 Dhenja e ndihmës palës me rastin e paraqitjes se kërkesës 1.5 Njoftimi i palëve përmes telefonit mbi ecurin e lendes (për marrjen e vendimit apo plotësimin e lendés)	Gjate gjith vitit	Zyrtaret e QSHQ-se	
2.Perdorimi dhe respektimi i akteve ligjore dhe nënligjore né mënyrë te drejte dhe té sakte.	1. Përdorimi dhe zbatimi i ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr.05/L-031 2. Përdorimi dhe zbatimi i udhëzimit administrativ për QSHQ-te 2011/03 3. Zbatimi i rregulloreve te brendshme komunale .	Gjate gjith vitit	Zyrtaret e QSHQ-se	

3.Percjellja e kërkesave /lendve tek drejtoritë përkatëse përmes sistemit dhe përmes dorëzimit fizik,gjate vitit 2020 do te përpiqemi qe dorëzimi fizik te eliminohet, do te përdoret veten ne raste kur është e domosdoshme.	3.1 Regjistrimi i lendeve ne librat e protokollit sipas Drejtorive/zyrave përkatëse. 3.2 Dorëzimi i lendve tek drejtorit/zyret përkatëse. 3.3. Pranimi i post s dhe shpemdarja e saj tek zyrtaret përgjegjës 3.4 shpemdarja e materialit zyrtar tek zyrtaret pergegjes 3.5 dërgimi i shkresave tek palët përmes postës dhe personalisht sipas nevojës.	Gjate ter vitit	Recepcionisti (dërguesi i postes) i QSHQ-se	Prej janarit deri ne qershor do te përpiqemi qe dorëzimi fizik i lendeve te eliminohet (vetëm ne raste kur është nevojshme)

Zyra për të drejtat e njeriut

Nr.	*Qëllimi i përgjithshëm*	*Aktiviteti*	*Stafi përgjegjës*	*Afati*	*Buxheti*
1.	Avancimi i pozitës shoqërore se femrës në vendimmarrje.	- Organizimin e Zyrës për Barazi Gjinore në mënyrë funksionale, qasje në problemet kyqe të femrave, trajnime promovuese dhe aktivitete tjera me njëjtin destinim.	Zyrtarja për Barazi Gjinore	Punë kontinuele gjatë vitit vijues	
2.	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare te gruas, 8 Marsit	- Organizimi e një Tryezë të hapur me temë: Pozita e femrës kryefamiljare në komunën	Zyrtarja për Barazi Gjinore.	Java e pare e marsit 8- Marsi. **Tryeze**	**1000€**
3.	Përgatitja e një data baze, statistikore për buxhetimin gjinore duke përfshirë punësimin mbrojtjen shëndetësore	- Vizita nëpër të gjitha institucionet publike dhe private më qëllim të verifikimit: a janë të mbrojtura të dy gjinitë sipas ligjit, a kanë kontrata a marrin rrogë njësoj, për punën e njëjte. Sa respektohet pushimi i lehonisë i garantuar me ligjin në fuqi	Zyrtarja për Barazi Gjinore, zyra e personelit ,Punëdhënësit Qendra për punësim dhe aftësim	Janar-Dhjetor	
4.	Vetëdijesimi në zonat rurale për të drejtat trashëgimorë	- Hulumtim i shkaqeve të braktisjes së shkollës nga nxënësit në komunën e Vushtrrisë, verifikimi i rasteve të nxënësve shkollimi i të cilëve varet nga pagesa e një bilete autobusi - Inicim i Seancave pa pagës me Psikologun për nxënës qe e braktisin shkollën, ose që kanë potencial për ta braktisur - Vizita në shkolla te komunës, ligjërata dhe aktivitete të ndryshme	Zyrtarja për Barazi Gjinore , Drejtoria e Arsimit , Drejtoret e shkollave Drejtoria për Mirëqenie Sociale Psikologu i Shkollës NJKDNJ, ZBGJ	**Ka filluar procesi, është ne vazhdimësi**	
5.	Shënimi i 1 qershorit Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve .	Shpallja e tregimit më të mirë për të drejtat e fëmijëve në shkolla fillore	ZDF dhe Asambleja e fëmijëve te komunës.	Qershor Eskrukrzion me fëmijë të hendikepuar	**500,00€**
6.	Inkurajimi i femrave në	- Përgatitja e raporteve statistikore të pjesëmarrjes së	Zyrtarja për Barazi	Punë permanente për	

	punësim dhe femrave që do të duhej të promovohen dhe personave me nevoja të veçanta.	femrave, gjithashtu edhe raporti mbi kualifikimin e tyre. - Organizimi i debateve, seminare trajnime. - Avokimi për njohjen dhe rishpërndarjen e punës së papaguar të grave; - Mbështetja e ndërmarrësisë së grave nëpërmjet trajnimit të aftësive dhe teknikave të prodhimit. - Mbështetja e përpjekjeve për të forcuar të drejtat ligjore të grave të prone	Gjinore Komuna Enti për punësim Qendra për punë sociale	gjatë gjithë vitit.	
7.	Subvencionimi i pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetë-ushqyese, përfituese të skemave sociale	-	Drejtoria për Mirëqenie Sociale Enti për Punë Psikologu i Shkollës	Permanent	

8.	Shënimi i 25-Nëntorit, Dita ndërkombëtare kundër dhunës në familje 25 Nëntori	- Organizimi i aktiviteteve gjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje - Fushatë vetëdijes ese kundër dhunës, më qëllim të uljes se rasteve të dhunës, tryeza të hapura me dy gjinitë.	Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyra e kryetarit Policia, Qendra për Punë Sociale.	25 Nëntor -10 Dhjetor	1.000,00
9.	Fuqizimi i Bashkëpunimit mes Zyrtares për Barazi Gjinore dhe OJQ përmes aktiviteteve te	- Organizimi i 4 takimeve gjate vitit me temë "Përkrahja dhe bashkëpunimi i OJQ-ve të grave të komunitetit	Zyrtarja për Çështje Gjinore. ZKK OJQ-ve	Punë Kontinuele gjatë vitit 2017/18	*2.400,00*

	përbashkëta	serb, turk, rom, ashkali etj në 4 tema specifike" aspektet dhe bashkëpunimi i me ngushtë me OJQ.			
10.	Organizimi fushatave vetëdijes ese kundër trafikimit më qenie njerëzore .	- 4 fushatave vetëdijesimi për parandalimin e trafikut më qenie njerëzore - Identifikimi i numrit te personave te trafikuar - Identifikimi Nevojave të tyre primare - Adresimi i këtyre kërkesave Institucioneve përgjegjëse	Policia e Kosovës Zyrtarja për Barazi gjinore, QPS Gjykata	Maj – Nëntor *Ne bashkëpunim me OJQ dhe KVLR*	*2.000,00*
11.	Aktivitete informuese për promovimin e të drejtës për pushimin e lehonisë		MALP Komuna		*100€*
12.	Inkurajimi i femrave vetushqyese në punësim dhe femrave që do te duhej të promovohen dhe personave me aftësi te kufizuar	- Përgatitua e raporteve statistikore te pjesëmarrjes se femrave gjithashtu edhe raporti mbi kualifikimin e tyre. - Të organizohen debate të ndryshme për këtë çështje dhe të organizohen seminare trajnime.	Komuna NJKDNJ	Punë Kontinuele	

14.	Shënimi i 1 Dhjetorit, Dita kundër SIDËS	- Organizimi i debateve takime, hulumtime dhe ligjërata nëpër shkolla	NJKDNJ	Dhjetor 2021	
15.	Shënimi i 10-Dhjetor Dita e të drejtave të njeriut	- Organizimi i debateve aktivitete sportive	NJKDNJ	Dhjetor 2021 Me KVLR	*300€ Ushqim tradicional*

-

Arsimi

Prioritetet kryesore në të cilat mbështet plani i punës i DKA-së janë:

- Mësimdhënie dhe mësimnxënie bashkëkohore
- Zhvillimi i përgjegjësisë dhe llogaridhënies
- Cilësia dhe kurrikula e re për zhvillim të qëndrueshëm
- Shkolla autonome me vlerësueshmëri
- Ofrimi i praktikave profesionale
- Partneritet me standardet e reja

Nr.	Objektivat	Aktivitetet	Financuar në Euro	Afati	Bartësit e aktiviteteve	Ndërlidhja me aktet tjera
1.	***Krijimi i kushteve bashkëkohore për mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive***	1.1.Furnizimi i shkollave me inventar	40,000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.2.Renovimi i ngrohjeve qendrore	30,000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.3 Ndërtimi i aneksit në SHFMU"A.Z.Çajupi" Vushtrri	5,000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.4. Ndërtimi i rrethonjave në shkolla	25,000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021

		1.5. Kuzhina për çerdhet e reja	20,000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.6. Meremetimi i shkollave	75,000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.7. Makina dhe pajisje për mësim praktik në SHMT''Lutfi Musiqi'' Vushtrri	20,000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.8. Ndërtimi i tualeteve në shkolla	25,000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	
		1.9. Ndërtimi i çerdhes se re	100,000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.10. Fusha sportive	35,000 euro	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.11.Salla sportive	50,000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.12.Pajisja me TIK	30, 000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.13. Pajisje laboratorike dhe mjete konretizimi	30,000	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e prokurimit DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.14. Depo	15,000.0	Janar-dhjetor	DKA Drejtoria e	

				prokurimit DUMM	
	1.15. Klima në Gjimnazin " Eqrem Çabej" Vushtrri	25,000		DKA Drejtoria e prokurimit	
	1.16.Transporti i nxënësve	190,000	Jan. - qersh. Shator dhjetor	Zyrtarët e DKA-së	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
	1.17.Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta	10,000	Jan. - qersh. Shator dhejtor	Zyrtarët e DKA-së	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
	1.18.Përfshirja e gjithë nxënësve në arsim pa marrë parasysh gjuhën dhe etninë,	Pa kosto	Janar-dhjetor	Zyrtarët e DKA-së	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 /STRATEGJIA PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEV E ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË KOMPONENTA E EDUKIMIT 2007-2017
	1.19. Funksionimi i ekipit për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore	Pa kosto	Janar-dhjetor	• Zyrtarët e DKA-së	UA.Nr.16 /Vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
	1.20. Objekte të qasshme për nxënës me nevoja të veçanta	Pa kosto	Janar-dhjetor	• DKA	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
	1.21. Ofrimin, motivimin,	Pa kosto	Janar-dhjetor	• DKA • MASH	Vlerësimi profesional i

		këshillimin, sugjerimin si dhe marrjen e masave për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në klasat e rregullta dhe ofrimi i asistenteve për fëmijë me nevoja të veçanta (2 ose 3)				fëmijëve me nevoja të veçanta edukative-arsimore Nr.07.2012
		1.22. Identifikimi i rasteve të braktisjes 1.23. Vlerësimi i nxënësve që braktisin shkollën 1.24. Riintegrimi në shkolla	Pa kosto	Janar-dhjetor	• DKA • MASH	UA-Nr.19/2012 Fuqizimi i ekipeve për parandalimin dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrim në arsimin e obliguar
		1.25. Zbatimi i protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në shkollat e komunës.	Koston e bartë organizata KEC& FIT	Janar-Dhjetor	• MASH • DKA • KEC • FIT	Plani i veprimit për zbatimin e protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në shkollat e komunës
2	***Koordinimi i përbashkët dhe përkrahja për rritjen e përgjegjësisë individuale e kolektive***	2.1. Monitorimin e mirëmbajtjes së pastërtisë në shkolla	Pa kosto	Janar-dhjetor	Zyrtarët e DKA-së	Ligji i Arsimit Parauniveristar/ Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
